

VENDIM
Nr. 146, datë 20.2.2013

PËR KALIMIN E PASURISË SË NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE NR. 8380 TË BASHKISË TIRANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 143, DATË 18.1.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE (PJESA E PARË+PJESA E DYTË) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË TIRANË TË QARKUT TË TIRANËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 pika 3, 10, 12, 13, 15/c e 16 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të nenit 8/a të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e pasurisë me numër rendor 402 (pjesa e parë), me emërtimin “Ish-kopshti nr. 9”, ndodhur në zonën kadastrale nr. 8380, me numër pasurie 7/102, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, për ndërtimin dhe shitjen e banesave, në zbatim të politikave sociale të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

2. Heqjen e pronës nr. 402 (pjesa e parë), me emërtimin “Ish-kopshti nr. 9”, nga lidhja nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 143, datë 8.1.2012 të Këshillit të Ministrave.

3. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet ky ent të lidhë kontratat e privatizimit me banorët e pastrehë, përcaktuar në listat që i bashkëlidhen këtij vendimi, sipas kushteve të privatizimit, të përcaktuara në udhëzimin nr. 22, datë 12.10.2010, të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, të ndryshuar.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha